



Thirrje publike për aplikim në shtandin shtetëror të Kosovës në panairin “Festivali Global i Gastronomisë Shqiptare 2024”

2-3 tetor 2024

Adresa: Berlin, Gjermani

Hyrje

Me qëllim të promovimit të kompanive kosovare të sektorit të ushqimit, pijeve, produkteve jo-ushqimore, TIK-ut, dhe drurit në gjetjen e tregjeve të huaja për eksport të produkteve dhe shërbimeve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) fton bizneset të aplikojnë përmes kësaj thirrje që të jenë pjesë e këtij aktiviteti ndërkombëtarë.

Ky aktivitet organizohet nga KIESA dhe projekti i USAID-it Compete Activity në koordinim dhe bashkëpunim me shoqatat prodhuese të sektorëve specifik. KIESA mbulon shpenzimet e hapësirës ekspozuese për pjesëmarrjen e 55 bizneseve vendore, ndërsa ndërtimi i shtandit standard për këto biznese do të mbulohet nga projekti i USAID-it Compete Activity, përderisa shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, ushqimit, dërgimin e materialeve promovuese etj., të bizneseve pjesëmarrëse do të mbulohen nga vet bizneset.

Afati për aplikim për pjesëmarrje është deri më 29.07.2024. Dokumentet e plotësuar si në vijim do të konsiderohen për vlerësim.

1. Aplikacioni i plotësuar me të dhënat bazike të subjektit aplikues;
2. Dëshminë që subjekti aplikues është i regjistruar në Republikën e Kosovës;
3. Dëshminë e xhirollogarisë aktive në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;
4. Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të subjektit aplikues;
5. Vërtetimin nga gjykata që dëshmon që personi i autorizuar i subjektit nuk është nën hetime (kërkohet origjinali, jo me i vjetër se 30 ditë);
6. Deklaratën nën betim;
7. Vërtetimin e qarkullimit vjetor të subjektit aplikues për vitin fiskal 2023 nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK); dhe
8. Vërtetimin tatimor të subjektit aplikues për obligimet e kryera ndaj ATK-së, jo më e vjetër se 90 ditë nga data e lëshimit.

Shënim: Në mungesë të cilit do dokument të kërkuar në listën e mësipërme, aplikacioni i subjektit aplikues do të diskualifikohet.



Të drejtë aplikimi kanë bizneset nga sektorët si në vijim:

- 20 biznese nga sektorët e Ushqimit dhe Pijeve, të cilët do të kenë në dispozicion një hapësirë ekspozuese prej 96 m²
- 10 biznese nga sektori Jo-Ushqimor¹, të cilët do të kenë në dispozicion një hapësirë ekspozuese prej 48 m²
- 10 biznese nga sektori i TIK-ut, të cilët do të kenë në dispozicion një hapësirë ekspozuese prej 36 m²
- 15 biznese nga sektori i Drurit², të cilët do të kenë në dispozicion një hapësirë ekspozuese prej 296 m².

Kriteret e vlerësimit:

- Produktet/shërbimet që subjekti aplikues do të ju ofrojë blerësve potencial në panair, maksimum 10 pikë:
 - 1 pikë për 1 produkt/shërbim
 - 3 pikë për 2 produkte/shërbime
 - 5 pikë për 3 produkte/shërbime
 - 7 pikë për 4 produkte/shërbime
 - 10 pikë për 5 e më shumë produkte/shërbime.
- Njohja e gjuhëve të huaja dhe aftësitë prezantuese, maksimum 10 pikë:
 - Gjuhë Angleze 5 pikë
 - Gjuhë Gjermane 4 pikë dhe
 - Gjuhë tjera 1 pikë.
- Materialet promovuese në gjuhët e huaja, maksimum 10 pikë:
 - Gjuhë Angleze 4 pikë
 - Gjuhë Gjermane 4 pikë dhe
 - Gjuhë tjera 2 pikë.
- Shtetet ku janë eksportuar produktet/shërbimet e subjektit aplikues gjatë vitit 2023, maksimum 10 pikë:
 - Shtetet e BE-së 5 pikë
 - Shtetet e CEFTA-së 3 pikë dhe
 - Shtetet tjera 2 pikë.
- Certifikime ndërkombëtare të subjektit, maksimum 5 pikë:
 - HACCP 3 pikë dhe
 - Certifikime tjera relevante sipas veprimtarisë 2 pikë.
- Paraqitja e subjektit aplikues në panaire ndërkombëtare në 5 vitet e fundit, maksimum 5 pikë:
 - 1 deri në 3 panaire 3 pikë dhe
 - 3 deri në 6 panaire 4 pikë.

¹ Jo-ushqimore – nënkupton kompanitë prodhuese të paketimit për industrinë ushqimore dhe pijeve (karton dhe letër).

² Sektori i drurit – përfshinë produktet e parafabrikuara, kuzhina industriale dhe mobilieria.

- Qarkullimi vjetor i subjektit aplikues gjatë vitit fiskal 2023, maksimumi 10 pikë:
 - 0 – 300,000 euro 4 pikë
 - 300,001 – 500,000 euro 8 pikë dhe
 - >500,001 euro 10 pikë.

Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë për të marrë pjesë në panair duhet të shprehin interesimin e tyre duke plotësuar aplikacionin dhe ta dërgojnë bashke me dokumentet e tjera në mënyrë elektronike më së largu deri më 29.07.2024 në e-mail adresën: Export.Kiesa@rks-gov.net

Në momentin e aplikimit subjekti pranon të gjitha përgjegjësitë, obligimet, kriteret dhe detyrat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e veçanta të parapara në këtë thirrje publike.

Informatat dhe dokumentet e kërkuara për aplikim mund të merren në KIESA-MINT, apo të shkarkohen nga faqet e internetit:

- ⇒ mint.rks-gov.net dhe kiesa.rks-gov.net apo në e-mail adresën:
- ⇒ Export.Kiesa@rks-gov.net

Shënim: Më 16.07.2024, në ora 9:30, në sallën e takimeve në KIESA, organizohet sesioni informues, ku KIESA dhe projekti i USAID-it Compete Activity do të ju njoftojnë më në detaje për aktivitetin dhe do tu përgjigjen pyetjeve lidhur me organizimin e panairit dhe mbështetjen e kompanive mbi përfaqësimin në festivalin e gastronomisë.